



Republike e Kosovës
Republic of Kosovo
Komuna e Glogocit
Municipality of Glogoc

Kryetari i Komunës

Nr 4653078 data 13.07.2010

Në bazë të nenit 10 paragrafi 1 e lidhur me nenin 4 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme nr. 03/L – 139 të Republikës së Kosovës, dhe nenit 13,82 dhe nenit 109 të Ligjit të procedurës administrative nr. 02/L – 28, pas shqyrtimit të komenteve dhe deklarave të palëve të datës 27.04.2010, Kryetari i Komunes brenda afatit ligjor merr këtë :

VENDIM PRELIMINAR

mbi ligjshmërinë e Shpronësimit të Propozuar

I. MIRATOHEJ Kërkesa e Subjektit Kërkues, të Ipeshkvisë së Kosovës për shpronësimin e një pjese të ngastrës kadastrale për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik – ndërtimin e Varrezave të Komunitetit Katolik në fshatin Llapushnik, Komuna e Glogocit dhe atë në pjesën e :

- ngast. kad. nr. 545 në vendin e quajtur "Gradina-Fusha" zona kadastrale Llapushnik, prona shoqërore që e ka në shfrytëzim NSH "Drenica" në Glogoc në sipërfaqe prej 02.50.00 ha me kulturë kullosa e klasit të VI-të, sipas fletës poseduese nr. 186 ZK Glogoc.

II. VËRTETOHET se është qëllim i ligjshëm publik dhe i domosdoshëm - Ndërtimi i varrezave të komunitetit katolik në fshatin Llapushnik sepse shpronësimi i një pjese të ngastrës kadastrale në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë është në funksion të arritjes së këtij qëllimi të ligjshëm publik.

III. Vendimin preliminar brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit, Organi shpronësues do t'ia dërgon pronarit, zotëruesit të interesit të pronës dhe personave tjerë që pretendojnë se i takon një e drejtë në pronën e shpronësuar.

IV. Ky vendim hyn në fuqi brenda 10 ditëve pas miratimit dhe në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në gazetën "Ekspres"

Arsyetim

Subjekti Kërkues – Ipeshkvia e Kosovës me Kërkesën nr. 31/10 të datës 05.03.201 ka kërkuar iniciimin e procedurës së Shpronësimit në lidhje me shpronësimin e një pjese të pronës së paluajtshme në ngastrën kadastrale me të dhënat e përshkruara si në pikën I të dispozitivit të këtij Vendimi preliminar e më qëllim të arritjes së qëllimit të ligjshëm publik – Ndërtimi i varrezave të komunitetit katolik në fshatin Llapushnik.

Ipeshkvia e Kosovës kësaj Kërkese ia ka bashkangjitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe i cili parashihet me dispozitën e nenit 8 lidhur me nenin 4 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme nr. 03/L – 139 të Republikës së Kosovës, pasi në këtë rast shpronësimi është njëri nga qëllimet e ligjshme publike – Ndërtimi i varrezave të komunitetit katolik në fshatin Llapushnik në lokacionin e përmendur më lartë, ky shpronësim në mënyrë të qartë dhe drejtpërdrejtë është i domosdoshëm për arritjen e të njëjtit qëllim, se shpronësimi në fjalë prek të drejtën pronësore të pronave të paluajtshme si dhe objekti i shpronësimit nuk janë zgjedhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues, dhe se Organi shpronësues i ka përmbushur të gjitha dispozitat e aplikueshme të këtij ligji.

Organi shpronësues – Kryetari i Komunës, me Vendimin nr.031-3579 të datës 19.03.2010, ka miratuar Kërkesën nr. 31/10 të datës 05.03.2010 të subjektit kërkues – Ipeshkvisë së Kosovës për iniciimin e procedurës së shpronësimit dhe për shqyrtimin e mëtejme të kësaj Kërkese .

Më datën 27.04.2010 me rastin e degjimit publik zotëruesi i interesit përkatësisht përfaqësuesi Agjencionit Kosovar për Privatizim e cila menaxhon me pronat shoqërore në Republikën e Kosovës ka deklaruar së e kundërshton në tërësi shpronësimin e propozuar me arsyetim së Organi shpronësues nuk ka bazë ligjore të bënë shpronësimin e pronës shoqërore në vështrim të nenit 44.2 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme.

Shpronësimi i një pjese të paluajtshme nevojitet për realizimin e punimeve me qëllim të ndërtimit e varrezave të komunitetit katolik në fshatin Llapushnik, e duke qenë se ky qëllim nuk mund të arrihet në mënyrë praktike pa kryerjen e shpronësimit të pjesës së kësaj ngastre kadastrale, se përfitimi publik nga shpronësimi është më i madh se interesi të cilat ndikohen negativisht nga shpronësimi dhe se pjesa e ngastrës kadastrale e cila do të shpronësohet, nuk është zgjedhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues siç parashihet në nenin 4 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme nr. 03/L – 139 të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Organi Shpronësues në pajtim me nenin 8 paragrafi 1.2 të këtij ligji pra brenda afatit prej 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi Preliminar, do të njoftoj pronarin ose Zotëruesin e Interesit të pronës shoqërore, pjesa e të cilës do të shpronësohet dhe personat të cilët pas pranimi për shqyrtim të mëtejme të Kërkesës për Shpronësim të Subjektit Kërkues – Ipeshkvisë së Kosovës dhe para marrjes së këtij Vendimi, kanë paraqitur pretendimin se janë pronarë ose zotërues të interesit në pjesën e

pronës të paluajtshme e cila është objekt i shpronësimit në këtë rast.


Po ashtu Organi Shpronësues në pajtim me paragrafin 4 të nenin 10 të këtij Ligji, brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, shpall Vendimin Preliminar në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në gazetën me tirazh më të madh në Kosovë.

Vendimi preliminar brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit, Organi shpronësues, do t'ia dërgon pronarit- zotëruesit të interesit të pronës në pajtim me nenin 10 paragrafi 3 të këtij ligji.

Organi shpronësues bënë shpalljen e Vendimit preliminar brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit në Gazetën zyrtare të Kosovës, dhe në gazetën „Ekspres“, derisa i njëjti hyn në fuqi në ditën e shpalljes sipas kushteve të përcaktuara në nenin 10 paragrafi 3 të këtij ligji dhe shpallja e tij do të bëhet në gjuhën zyrtare përkatëse e në pajtim me nenin 43 të ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme.

Prandaj duke qenë se janë plotësuar kushtet ligjore për iniciimin e procedurës së shpronësimit dhe se Kërkesa për shpronësim e Subjektit kërkuar është e bazuar, u vendos si në dispozitivin e Vendimit dhe në pajtim me nenin 10 lidhur me nenin 4 të Ligjit për Shpronësimin e pronës së paluajtshme nr. 03/L – 139 të Republikës së Kosovës.

Udhëzim për mjetin juridik : Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka të drejtën e paraqitjes së padisë në Gjykatën Komunale në Glllogoc brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi e këtij vendimi e nëpërmjet Organit Shpronësues.



Kryetarit të Komunës

Nexhat Demaku

Vendimi u dërgohet :

Pronarit ose zotëruesit të interesit

Kërkuar të shpronësimit

Arkivit